

Shërbimet në dispozicion përpara se të paguhet shuma juaj zbritëse

Të gjitha planet paguajnë për kujdesin parandalues përpara se të paguhet shuma juaj zbritëse.



Planet e Cascade Care paguajnë më shumë shërbime përpara se të paguhet shuma juaj zbritëse. Këto shërbime përfshijnë:



Kujdesin parandalues



Vizita e mjekut të kujdesit parësor për trajtim të sëmundjes ose lëndimit



Shërbimet e shëndetit mendor



Recetat e përgjithshme



Kujdesin urgjent, kur keni nevojë për kujdes menjëherë, por nuk keni urgjencë siç është sulmi në zemër.

Si të regjistrohem?

Telefononi



1-855-923-4633

TTY/TDD: 1-855-627-9604

Orari: 7:30 AM deri 5:30 PM

Ndihma ofrohet në mbi 200 gjuhë.

Lidhuni



Caktoni takim me një burim të besuar në komunitetin tuaj.



Gjeni një udhëzues ose ndërmjetës të kujdesit shëndetësor për t'ju ndihmuar nëpërmjet internetit në wahealthplanfinder.org. Klikoni në butonin Merr mbështetje (Get Support).

Vizitoni



Skanoni kodin QR

Vizitoni ueb faqen në: wahealthplanfinder.org

Sigurim shëndetësor i hapur për të gjithë!

Kushdo që jeton në shtetin e Washington mund të blenë sigurime shëndetësore dhe dentare nëpërmjet Washington Healthplanfinder.



Të gjitha statuset e imigracionit janë të mirëseardhura!

Ky program është për të gjithë, pavarësisht nga dokumentimi.

Siguria juaj është e rëndësishme për ne:

- Marrja e sigurimit shëndetësor nuk ndikon në statusin e imigrimit ose aplikacionet për shtetësi për ju, familjen tuaj ose këdo që jeton me ju.
- Informacioni juaj personal nuk përdoret për qëllime të detyrimit të imigracionit.
- Informacioni në lidhje me statusin tuaj të imigrimit përdoret vetëm për të përcaktuar se cilat plane të sigurimeve shëndetësore kualifikoheni t'i blini.

Çka është sigurimi shëndetësor?



Sigurimi shëndetësor është marrëveshje që bëni me një kompani sigurimesh. Kompania e sigurimit

pranon të paguajë për disa ose të gjitha shpenzimet tuaja mujore në këmbim të pagesës suaj mujore (këstit).

Përse të keni sigurim shëndetësorë?

Sigurimi shëndetësor ndihmon në pagesën e kostos së kujdesit shëndetësor, pavarësisht nëse e përdorni për të qëndruar të shëndetshëm ose kur jeni i sëmurë.

Sa kushton?

Kostoja e blerjes së sigurimit shëndetësor varet nga gjëra të tilla si të ardhurat tuaja, madhësia e familjes dhe vendi ku jetoni. Ju mund të kualifikoheni për Cascade Care Savings që do të thotë se shteti do të paguajë për një pjesë të sigurimit tuaj shëndetësor. Nëse kualifikoheni, shuma që paguani për kujdesin shëndetësor do të jetë më e vogël.

Si funksionon sigurimi shëndetësor?

Ju paguani një këst mujor në rast se keni nevojë për kujdes shëndetësor. Pastaj, nëse keni nevojë për shërbime të kujdesit shëndetësor, këto shërbime do t'ju faturohen me një tarifë të zbritur.

Kushtet e sigurimit shëndetësor

Kësti

Secili anëtar paguan një tarifë mujore të quajtur këst. Çmimi i këstit tuaj varet nga plani juaj i sigurimit shëndetësor.



I zbritshëm

Sigurimi juaj shëndetësor fillon të ndihmojë për të paguar faturat tuaja pasi të "paguani shumën tuaj zbritëse". Të gjitha planet paguajnë për gjëra të caktuara, si janë kontrollet shëndetësore, përpara se të paguhet shuma zbritëse.

Bashkëpagesa dhe bashkë sigurimi

Këto janë shpenzimet që do të paguani kur të shkoni te mjeku. Bashkëpagesa juaj është një shumë fikse (\$1-\$50). Bashkë sigurimi juaj është përqindje e kostos së shërbimit. Planin juaj i sigurimit shëndetësor paguan për pjesën tjetër të vizitës suaj.

Shembuj të faturave mjekësore

Jeni sëmurë dhe keni nevojë për kujdes mjekësor.
Fatura juaj mjekësore është \$10.000.

Ju nuk keni sigurim.

Totali që paguani (nga xhepi): \$10.000

Me sigurimin ju paguani shumë më pak.
Sigurimi paguan: \$7.960

Totali që paguani (nga xhepi): \$2.040

- I zbritshëm: \$2.000
- Bashkëpagesë: \$40

Cilat plane të sigurimit shëndetësor janë në dispozicion?

Janë tri nivele të planeve të sigurimit shëndetësor në dispozicion nëpërmjet *Washington Healthplanfinder*. Bronz, Argjend dhe Ar.

Shuma që paguan kompania juaj e sigurimit shëndetësor varet nga niveli që zgjidhni. Planin Bronz paguan rreth 60%, planin Argjend paguan rreth 70%, dhe planin Ar paguan rreth 80% të faturave tuaja mjekësore.

Bronz

Këto plane kushtojnë më pak në muaj, por paguajnë më pak për shpenzimet kur keni nevojë për kujdes.

Argjend

Këto plane mbulojnë më shumë shpenzime kur keni nevojë për kujdes, por mund të kushtojnë më shumë. Nëse kualifikoheni për Cascade Care Savings këto plane mund të kushtojnë më pak se planet Bronz.

Ar

Këto plane kushtojnë më shumë në muaj, por paguajnë më shumë për shpenzimet kur keni nevojë për kujdes. Nëse kualifikoheni për Cascade Care Savings dhe keni nevoja të konsiderueshme për kujdes shëndetësorë këto plane mund të jenë të përshtatshme.

Kërko logon e Cascade Care!

Planet e Cascade Care ofrojnë më shumë vlerë me kosto më të ulët. Që do të thotë, pagesa e kësteve tuaja do të ju ofrojë më shumë se kurrë!

